



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.2.2022, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Nasip Naço – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare", në cilësinë e komisionit përgjegjës.

Marrin pjesë:

Nasip Naço, Xhemal Qefalia, Ferdinand Xhaferraj, Bardhyl Kollçaku, Pranvera Resulaj, Denis Deliu, Luan Duzha, Ilirian Pendavinji, Lindita Metaliaj, Ervin Salianji, Kasem Mahmutaj, Isuf Çelaj.

Mungojnë:

Antoneta Dhima, Toni Gogu, Vullnet Sinaj, Paulin Sterkaj, Flamur Noka, Enkelejd Alibeaj, Agron Çela, Luan Baçi.

Të ftuar:

Dallëndyshe Bici – Zëvendësministre e Mbrojtjes

Ardit Çollaku - Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes

Emërush Bejdo - Kapiten i Rangut të I-rë, komandant i Hidrografisë në KFD-në e Ministrisë së Mbrojtjes

HAPET MBLEDHJA

Nasip Naço - Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Sigurisë Kombëtare me këtë rend dite, me shqyrtimin e projektligjit "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare", në cilësinë e komisionit përgjegjës.

Sot në komision kemi përfaqësuesit e Ministrisë e Mbrojtjes, zonjën Dallëndyshe Bici, zëvendësministre e Mbrojtjes, zotin Ardit Çollaku, drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes, dhe zotin Emërush Bejdo, kapiteni i rangut të I-rë, Komandant i Hidrografisë në Forcat e Armatosura.

Ftoj përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes të na bëjnë një përmbledhje të shkurtër.

Faleminderit!

Dallëndyshe Bici – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Sot Ministria e Mbrojtjes vjen përpara këtij komisioni me projektligjin "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Organizatën Ndërkombëtare Hidrografike", një konventë e krijuar që në vitin 1921 dhe që nga ajo ditë ka si mision të saj lehtësimin e procedurave dhe sigurimin e informacionit hidrografik për mbarë botën, me qëllim sigurimin e informacionit në lundrim nëpërmjet bashkërendimit të punës me shërbimet hidrografike kombëtare të secilit vend anëtar.

Nismëtare për këtë aderim të Republikës së Shqipërisë është Ministria e Mbrojtjes së bashku me mbështetjen e institucionit, i cili do të jetë në vijën e parë në zbatimin e detyrimeve që do të rrjedhin nga kjo konventë, që është Shërbimi Hidrografik i Komandës së Forcës Detare të Forcave të Armatosura.

Përfitimet që do të na sjellë anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në këtë konventë janë: ruajtja dhe zhvillimi i kapaciteteve teknike dhe njerëzore, ndikimi në sigurinë e ekonomisë detare, ndikimi në zhvillimin ekonomik, zhvillimin e marrëdhënieve shumëpalëshe me shtetet aleate të rajonit dhe më gjerë. Anëtarësimi ynë do të na mundësojë plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e detarisë, hidrografisë, si dhe do t'i mundësojë vendit tonë një ambient më të sigurt, më të zhvilluar si në fushën e mbrojtjes, po ashtu edhe në atë të turizmit apo të infrastrukturës lundimore. Fatura financiare që do të na kushtojë për aderimin në këtë organizatë është 8 mijë euro, e cila është

llogaritur mbi bazën e tonazhit të Flotës Detare, që është deri në 100 mijë tonë, dhe kjo pagesë është parashikuar në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2022.

Përfitimet ekonomike të Shqipërisë nga shfrytëzimi i qëndrueshëm i ekonomisë blu, nga shitja e hartave detare në letër apo ato elektronike, si dhe nga botimet e tjera hidrografike do të jenë të mjaftueshme për ta justifikuar këtë shumë për aderimin.

Në mbyllje, me dëshirën për të vazhduar bashkëpunimin në bazë ndërqeveritare në hidrografi, si dhe për të gjitha arsyet e mësipërme, Ministria e Mbrojtjes propozon dhe mbështet anëtarësimin e vendit tonë në këtë organizatë ndërkombëtare.

Ju faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zonja Bici!

Fjala për zotin Denis Deliu, si relator i projektligjit.

Denis Deliu – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar zëvendësministre,

Të nderuar përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes,

Do të mundohem ta relatoj sa më shkurt, pasi zëvendësministrja e lexoi qartë relacionin.

Unë sot jam caktuar relator për projektligjin "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare". Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë propozon anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare.

Miratimi i këtij projektvendimi është në përputhje me politikat e Ministrisë së Mbrojtjes në kuadër të anëtarësimin në NATO, si dhe në përputhje me programin e qeverisë shqiptare për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare.

Nënshkrimi i projektvendimit për propozimin e projektligjit "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare" do të sjellë një rritje të sigurisë, stabilitetit dhe efikasitetit të Forcave tona të Armatosura.

Nënshkrimi i aktit është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjin nr.10100, datë 26.3.2009, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Atlantikut të Veriut".

Ky projektakt nuk synon përafrimin me ndonjë *aquis communitaire* të Bashkimit European.

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektakti dhe më pas edhe të konventës, që miraton projektaktin për Republikën e Shqipërisë, janë Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Mbrojtjes.

Për sa u përket efekteve financiare të anëtarësimit, përlllogaritja e kostos bëhet me formulë përkatëse, bazuar në tonazhin e Flotës Tregtare dhe anijeve të Flotës Detare mbi 100 tonë, që me kapacitetet e vendit tonë mund të jenë rreth 8 mijë euro në vit. Ministria e Mbrojtjes ka realizuar përlllogaritjet përkatëse. Efektet do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

Unë i ftoj të gjithë kolegët ta miratojnë këtë projektligj.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Deliu!

A ka pyetje në lidhje me projektligjin? Zoti Xhaferraj, fjala është për ju.

Ferdinant Xhaferraj – Faleminderit, zoti kryetar!

Dua ta falënderoj zëvendësministren dhe relatorin për përshkrimin që bënë.

Së pari, doja të dija pse po aderojmë kaq vonë në këtë organizatë?

Së dyti, për të qartësuar edhe opinionin publik, bëhet fjalë për hidrografinë, që kërkon një matje sa më të saktë dhe profesionale të ujërave të detit, a mendoni se mund të na japë edhe ndonjë ndihmë anëtarësimi në organizatë për problemet që kemi me marrëveshjet detare?

Atëherë, po e përsërit edhe një herë pyetjen e parë ishte: pse po aderojmë vonë dhe cilat do të ishin realisht përfitimet që do të kemi? Pra, deri tani a i kemi ne kapacitete në lidhje me matjen e ujërave? A mund të na ndihmojë aderimi në organizatë? Do të doja një informacion më shumë për të qartësuar edhe opinionin publik.

Faleminderit!

Dallëndyshe Bici – Dakord, po ia kaloj fjalën kolegut.

Për sa i takon pyetjes së parë, në dijeninë time, ka ardhur disa herë si propozim, por nuk ka kaluar, nuk jam në dijeni për arsyet.

Ndërsa për sa i takon pyetjes së dytë, që është më teknike, do të përgjigjet kolegu.

Emërush Bejdo - Faleminderit!

Në lidhje me pyetjen e parë, thjesht dua të shtoj që si iniciativë ka filluar që në vitin 2009, por për burokraci ka ngelur, sepse ne jemi krijuar që në vitin 1957, organizata vetë në vitin 1921 dhe sot dua ta quaj arritje që ne po e finalizojmë këtë proces, sepse kemi vetëm të mira nga ai. Në lidhje me pyetjen e dytë, që a i kemi ne kapacitete hidrografike dhe a mund të kontribuojnë ato për

çfarë po bën sot Shqipëria, do të thosha po. Shërbimi Hidrografik që nga viti 2018 ka kapacitete hidrografike dhe do të thosha se i ka shumë të mira, pasi kemi teknologjinë e fundit falë një projekti që ne kemi pasur me Norvegjinë. Kemi marrë edhe anijen hidrografike, edhe kapacitetet e përpunimit. Domethënë, janë 2 institucione që kanë përfituar nga ky projekt: Shërbimi Hidrografik dhe Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake.

Pra, aktualisht Shqipëria prodhon harta detare elektronike dhe ato shiten në formë elektronike. Këto shitje bëhen nëpërmjet një kompanie norvegjeze, kompania “Primar”, që është kompani lider në këtë fushë dhe mbulon 95% të tregut botëror. Ne aktualisht shesim 4 harta, por ku ka zona interesi, ku bëhen porte të reja, ku ka zhvillime të reja në bregdetin shqiptar, ne herë pas here kryejmë rilevime batimetrike dhe të një saktësie me 95% konfidencë, pra që është një standard i pranuar edhe nga kjo organizatë, në të cilën po aderojmë tani.

Pra, është mundësia, ka vetëm një dizavantazh, kjo është mundësia e vetme, që ne kemi dhe kërkon mirëmbajtje, pasi programi, licenca e programit të multibimit, që ne kemi në anije është e vetme, nuk kemi rezervë, por një kapacitet e kemi dhe qëllimi i projektit ky ka qenë: ndërtimi i kapaciteteve kombëtare dhe pastaj Shqipëria t’i zhvillojë vetë këto kapacitete.

Nasip Naço – Faleminderit!

Do të doja edhe unë të bëja një pyetje. Nga relacioni që ka ratifikuar këtë marrëveshje del se janë pjesë e kësaj konvente rreth 94 shtete, sa shtete lagen nga Deti Mesdhe, ose cilat janë shtetet që nuk janë pjesë e kësaj konvente, por që janë pjesë e Detit Mesdhe apo zonës përreth?

Faleminderit!

Dallëndyshe Bici – I nderuar zoti kryetar, vetëm Shqipëria nuk është aderuar për sa i takon bregdetit të Mesdheut në këtë organizatë.

Nasip Naço – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Salianji.

Ervin Salianji – Faleminderit!

Që ta kuptojmë ne, por edhe publiku, thatë se kjo është një marrëveshje që është propozuar që në vitin 2009 apo që ekziston në sirtarët e shtetit, nuk ka rëndësi në ministri apo në Kuvend, në komisionet parlamentare. Kjo nuk ka kaluar deri tani për çështje burokratike, për çështje parash, pavarësisht se janë 8 mijë euro në vit sipas relacionit, apo ka ndonjë bllokim politik apo ndonjë arsye tjetër?

Pyetja tjetër: pse na duhet kjo marrëveshje? Kjo ka lindur si nevojë e ministrisë apo si kërkesë e dikujt, apo si kërkesë nga vetë organizata për t'u anëtarësuar edhe Shqipëria, meqenëse nuk është? Pra, nga ka ardhur propozimi dhe nga kush është refuzuar, sepse zëvendësministrja tha pak më parë që ka pasur më përpara propozim, por është refuzuar? Pra, nga kush është refuzuar: nga qeveria, nga Kuvendi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta dëgjojmë nga kush është refuzuar.

Nëse ka që në vitin 2009 në rri, mos nuk na duhet, 8 mijë euro të mos i harxhojmë kot nga ministria, më mirë të bëjmë diçka për ushtarakët?!

Kapiteni tha që ne kemi teknologjinë e fundit në hidrografi, me një prej kompanive norvegjeze lider, nëse nuk gabojmë. Në qoftë se e kemi teknologjinë e fundit, cili është përfitimi i Shqipërisë nga kjo? Pra, pse vjen një marrëveshje, e cila nuk ka ndonjë përfitim të madh, ka një kosto të vogël prej 8 mijë eurosh, por sido që të jetë kalon në parlament, në qeveri, në Ministrinë e Jashtme, me ratifikim, sikur po anëtarësohemi në një organizatë të rëndësishme? Ta kuptojmë edhe ne, por më shumë edhe për publikun.

Ardit Çollaku – Faleminderit për pyetjet!

Për t'i marrë pak me radhë përgjigjet, do të thosha se lidhur edhe me vetë ndryshimet që vetë Organizata Hidrografike Ndërkombëtare ka pasur në tërësinë e saj, pra vetë organizata ka pasur ndryshime të vazhdueshme gjatë këtyre viteve të fundit, dhe ndryshimi i fundit, që i përket vitit 2016, ka bërë të mundur që edhe ne të qartësojmë kuadrin ligjor, se ku duhet të mbështeteshim për aderimin përkatës. Duke filluar pikërisht nga ky vit kanë filluar edhe bashkëbisedimet e fundit mes forcave përkatëse, mes Shërbimit Hidrografik Shqiptar dhe përfaqësuesve të organizatës, fatmirësisht, këtu kemi edhe gjeneral Kollçakun, që ka qenë pjesë e vazhdueshme e këtij procesi gjatë periudhës kur ai ka qenë edhe shef i Shtabit të Përgjithshëm, dhe më në fund kemi arritur në finalizimin përkatës, ku gjatë vitit 2021 u propozua nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë aderimi në këtë organizatë. Pra, nuk kishim arritur asnjëherë në fazën që jemi sot.

Për sa u përket përfitimeve që ne do të kemi nga ky aderim në këtë organizatë, pa dyshim që kemi një kosto prej 8 mijë eurosh në vit, që janë kosto aderimi, por nëse u kthehemi përfitimeve, ato janë shumë herë më të mëdha. Ne sot nuk kemi një shërbim hidrografik, le të themi kartografik apo hartografik të moderuar, modern, nuk kemi një staf të trajnuar. Pra, nëse ne do t'i referohemi vetëm pjesës së trajnimit, që mund të përfitojë një anëtar i stafit të Shërbimit Hidrografik apo edhe

i Institutit të Gjeografisë Ushtarake, që është një tjetër institut që përfiton nga ky shërbim, nëse një trajnim do të kushtojë 4 mijë euro, që është kosto minimale, për një trajnim 3-mujor kostot arrijnë deri në 30 mijë euro. Pra, vetëm nga shërbimet e trajnimeve përfitimi do të jetë i përlllogaritur rreth 10 apo 12 herë më i madh, pa përlllogaritur vlerat e hartave, apo pjesën e kartografisë, që mund të shiten *online*.

Ervin Salianji – Pra, deri më sot vetëm për shkak të neglizhencës, me sa kuptova, shteti shqiptar ka humbur mijëra euro, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tha se një shërbim do të merret 10 herë më pak, pra nga 30 mijë euro, në 3 mijë euro. Për shkak të një neglizhence shteti shqiptar deri më sot paska humbur mijëra euro.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nasip Naço – Faleminderit!

Ardit Çollaku - Jo, janë procedura që gjatë negociatave marrin kohën e tyre. Pra, nëse negociatat kanë filluar që në vitin 2009 dhe nuk janë finalizuar deri në vitin 2016, në vitin 2016 organizata ka pasur ndryshimet e veta dhe prej atij viti ne kemi bërë negociata të tjera, që, fatmirësisht, po i finalizojmë me sukses.

Nasip Naço – Zoti Xhaferraj, fjala për ju.

Ferdinant Xhaferraj – Ju jeni zyrtarë të shtetit, që punoni, por në çdo moment, brenda sinqeritetit tuaj, ju gjithmonë prodhoni evidencë që nuk ka lidhje me ju, që kjo qeveri, nëse nuk përfiton diçka vetë, çështja zvarritet, nuk ka interes ta çojë përpara, pavarësisht se zgjat, pavarësisht se humbet apo jo. Vetëm nëse shikohet që është fitim i garantuar për atë që është në krye ecin proceset, të gjitha të tjerat nuk kanë të bëjnë fare me ju, nuk e kisha fare me ju, ju jeni brenda sinqeritetit tuaj dhe e përshkruani siç ka ndodhur në të vërtetë, por ne këtë e ndeshim në çdo moment dhe kudo, këtë e ndesh çdo qytetar. Kështu që, ju falënderoj për përshkrimin teknik që bëtë!

Nasip Naço – Faleminderit!

Po, zoti Çelaj.

Isuf Çelaj – Përshëndetje, zoti kryetar!

Faleminderit!

Pyetja ime është: a i ka Ministria e Mbrojtjes kapacitetet për të përfituar nga projektet e kësaj marrëveshjeje? Pyetja është për zotin kapiten.

Faleminderit!

Emërush Bejdo – Ju faleminderit për pyetjen!

Po, Shërbimi Hidrografik i ka kapacitetet. Sot jemi rreth 30 vetë që shërbejmë në Shërbimin Hidrografik, nga këta 10 janë oficerë, të cilët kanë mbaruar në akademitë më të mira që kemi në rajon dhe përfitimi i parë janë trajnimet dhe ruajtja e standardeve. U pyet se çfarë përfitojmë, nuk përfitojmë thjesht trajnimet, kjo është organizatë që vendos standardet në fushën e hidrografisë dhe Shqipëria, duke u bërë pjesë e kësaj organizate, ruan këto standarde. Domethënë, ne jemi të gatshëm të kemi kapacitete për të përfituar nga kjo organizatë.

Nasip Naço – Faleminderit!

Po, zonja Metaliaj.

Lindita Metaliaj – Faleminderit, kryetar!

Pa dyshim, në parim anëtarësimi i Shqipërisë në organizatën ndërkombëtare ka një sërë qëllimesh pozitive, pasi u përmendën edhe përfitimet, edhe pse është në tryezë që në vitin 2009, tashmë ka gjetur zbatim dhe ka ardhur në komision për diskutim.

Në fakt, mua më nxitën disa çështje për të bërë disa pyetje.

Së pari, pse ka lindur pikërisht tani nevoja, për të vijuar me pyetjen e kolegut Xhaferraj, dhe cila është një ndër arsyet që ka diktuar tashmë anëtarësimin e Shqipërisë në këtë organizatë? A ka pasur një vlerësim paraprak nga Ministria e Mbrojtjes lidhur me mangësitë, që ajo vetë kishte fillimisht, apo të Forcave Detare, apo të institucioneve të tjera përkatëse në këtë drejtim, që të plotësoheshin përpara anëtarësimit?

Kam edhe diçka tjetër lidhur me përfitimet, të cilat në relacion shpjegohen përciptazi, por unë dua të diskutoj pak më konkretisht në lidhje me përfitimet që subjektet tregtare dhe personat juridiko-publikë do të kenë pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë.

Faleminderit!

Emërush Bejdo – Ju faleminderit!

E para, dua të sqaroj këtë pikën për vitin 2009, se më duket se ngecëm te kjo. Në 2009-n ka qenë vizita e ish-komandantit të Forcave Detare të asaj kohe në IHO, në Monako, domethënë që atëherë shteti shqiptar ka prodhuar një shkresë për këtë, por nuk është se te ne ka ardhur në këtë fazë.

Pyetët: “Pse tani”? Në vitin 2018 në Shqipëri ka bërë një vizitë një grup teknik i Organizatës Ndërkombëtare të Hidrografisë, i cili ka bërë një raport në fund të vizitës dhe

rekomandim kryesor për Shqipërinë që të ecë në rrugën e duhur në fushën e hidrografisë ka qenë që të futet nën ombrellën e IHO-s, pra të bëhet anëtar i IHO-s. Pra, këtë ne e quajmë një mbështetje të madhe, si një udhërrëfyes për në IHO.

Për pikën e fundit, kush përfiton, nëse ne kemi një shërbim hidrografik profesional, shumë të pajisur, të trajnuar dhe të modernizuar, të gjitha produktet hidrografike: si hartat detare, udhëzuesit e lundrimit, lajmet e ndryshme që lëshon shërbimi hidrografik, janë të një standardi të mirënjohur ndërkombëtar. Nëse themi që porti i Durrësit ka këtë thellësi, atëherë kjo thellësi është e mirëpranuar, pasi e ka nxjerrë një institut shkencor, një vend anëtar i IHO-s, dhe harta detare pranohet nga të gjitha anijet e huaja që vijnë në portet tona, nuk ka dyshime për certifikim. Domethënë, nuk ngrihen pikëpyetje që ky vend nuk është anëtar i IHO-s, apo nuk ka standarde të larta.

Nasip Naço – Faleminderit!

Duke qenë se nuk ka më pyetje, fillojmë nga diskutimet.

Zoti Kollçaku keni fjalën.

Bardhyl Kollçaku – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit përfaqësuesit të Ministrisë së Mbrojtjes!

Për mua është një rast shumë i mirë që të falënderoj strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes, kryesisht Forcat Detare të Institutit të Gjeografisë dhe të Infrastrukturës Ushtarake! Sot po diskutojmë një punë që ka nisur disa vite më parë dhe jam krenar që kam pjesë e inicimit të këtij procesi, do të ketë gjithmonë një fillim.

Kjo marrëveshje nuk është politike dhe nuk ka asnjë prapaskenë, por është ushtarake dhe është në të mirën e sigurisë kombëtare, është në funksion të lundrimit të sigurt të Forcave Detare, por edhe të kontributit të Republikës së Shqipërisë për sigurinë e lundrimit jo vetëm në Detin Mesdhe, por edhe më gjerë. Hartat dhe kapacitetet e Forcës Detare janë të standardeve të mirëpranuara botërore. Me këtë rast falënderoj Mbretërinë e Norvegjisë për kontributin që ka dhënë me projektin për anijen e hidrografisë, por edhe për pajisjet speciale për Institutin e Gjeografisë! Prodhojmë hartat që janë të pranuar, e tha edhe kapiteni i rangut të II-të, dhe këto jo vetëm plotësojnë nevojat tona ushtarake dhe ekonomike për anijet komerciale, por janë të disponueshme edhe për të gjithë përdoruesit në rajonin tonë, qoftë në aleancë, por edhe për tregti.

Jam i sigurt që nga shitja e këtyre hartave do të ketë një të ardhur që do ta kalojë shumëfish koston e tarifës 8 mijë euro në vit. Nga ana tjetër, përfitimet për trajnimin e ushtarakëve të Forcave

Detare, që është një grup i shkëlqyer i oficerëve dhe nënoficerëve, të cilët janë të shkolluar në akademitë më të mira perëndimore, por edhe me eksperiencë të gjatë në operacionet e NATO-s dhe në stërvitje të ndryshme, do t'u paraprijnë shumë zhvillimeve dhe stërvitjeve me aleatët strategjikë *Defender*, siç ishte *Defender 21*, apo *Defender 23*, ku porti i Durrësit dhe i Vlorës janë dy pikat hyrëse për operacionet detare, por do t'i shërbejnë edhe anës ushtarake, por edhe sigurisë së lundrimi komercial.

Prandaj, unë mendoj se përfitimi është i qartë, duhet të kishte ndodhur më herët, por më mirë vonë se kurrë. Unë them që ta miratojmë së bashku, edhe me kolegët e opozitës, sepse është një e mirë kombëtare.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Kollçaku!

Zoti Salianji.

Ervin Salianji – Faleminderit!

Është e qartë që shteti shqiptar, në këtë rast qeveria, ka neglizhuar një marrëveshje, duke humbur paratë e taksapaguesve shqiptarë. Kështu që, duke qenë se edhe nga përfaqësuesit e maxhorancës, edhe nga gjenerali u tha pak më parë që kjo është një marrëveshje e mirë, e cila do të ketë përfitime financiare qoftë për trajnimin e personelit, qoftë përfitimet që vijnë nga shitja e hartave, gjë që u tha edhe nga përfaqësuesit e qeverisë, ne do ta votojmë pro, por duhet theksuar edhe një herë tjetër neglizhenca e qeverisë në çdo projektligj, në çdo akt apo në çdo marrëveshje, që nuk ka përfitime të drejtpërdrejta për ndonjë pjesëtar të qeverisë apo për ndonjë zyrtar të lartë, për ta kaluar me procedura, siç kanë kaluar inceneratorët apo shumë prej aferave të tjera korruptive në këtë vend.

Marrëveshje si këto, që u shërbejnë ushtarakëve dhe shtetit shqiptar, lihen nëpër sirtarët e shtetit, për të mos kaluar dhe për të mos u marrë me seriozitet të plotë, ashtu sikurse sot nuk ka ardhur edhe gjysma e anëtareve të komisionit, përfaqësues të maxhorancës. Megjithatë, duke qenë se është një përfitim për shtetin shqiptar, ne do ta votojmë pro.

Nasip Naço – Faleminderit për votën! Në rastin konkret edhe ju jeni pjesë e kësaj nisme! Fjalën e ka kërkuar zonja Resulaj, pastaj zoti Xhaferraj.

Pranvera Resulaj – Faleminderit, kryetar!

Në fakt, kam një koment shumë të shkurtër në lidhje me rëndësinë, sikundër e kuptoj unë, për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, që është aderimi në Konventën e Organizatës Hidrografike.

Në fakt, u përmend pak në relacion edhe nga zëvendësministrja koncepti i ekonomisë blu dhe do të doja të theksoja që Shqipëria është pjesë e nismës adriatiko-joniane për zhvillimin e ekonomisë blu, me fokus ndërlidhjen rajonale, zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, mjedisin, cilësinë e mjedisit. Sigurisht, koncepti i ekonomisë blu lidhet me shfrytëzimin e ujërave në funksion të zhvillimit ekonomik, kryesisht të turizmit, peshkimit, transportit, akuakulturës, zhvillimit të aktiviteteve të tilla nënujore, që në thelbin e tyre kanë një aktivitet tregtar, që sjell ndikim në zhvillimin ekonomik. Flitet gjerësisht për ekonominë blu, prandaj mendoj se edhe aderimi i Shqipërisë në këtë konventë, Organizatën Hidrografike, do të jetë në funksion edhe të zhvillimit të ekonomisë blu. Pra, të gjitha këto aktivitete ndërlidhen në një farë mënyre edhe me funksionet që ofron kjo konventë.

Ky ishte thjesht një koment për të treguar që do të ketë ndikim edhe në zhvillimin e ekonomisë blu.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zonja Resulaj!

Po, zoti Xhaferraj!

Ferdinant Xhaferraj – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë i falënderoj zyrtarët e Ministrisë së Mbrojtjes për përshkrimin dhe qartësimin që bënë! Pa diskutim, si për çdo marrëveshje, edhe për këtë konventë vota e opozitës është pro. Por, siç doli nga përshkrimi që bënë zyrtarët e Ministrisë së Mbrojtjes, guri i themelit për aderimin në këtë konventë është vendosur në vitin 2009, dhe kjo tregon, besoj bien dakord edhe kolegët e rilindjes, se sa herë që diskutojmë në komision për investime, për marrëveshje, për konventa, shumica e tyre, të mos themi të gjitha, gjenezën e kanë në kohën e qeverisjes sonë. Ju janë dashur gati 10 vjet dhe akoma mezi arrini të paketoni apo ambalazhoni projekte, marrëveshje apo konventa që kanë nisur në kohën kur qeveriste PD-ja.

Kjo flet shumë dhe është e qartë edhe për qytetarët shqiptarë, arsyeja është një: i vetmi instrument që çon përpara punët gjatë kësaj qeverisjeje është korrupsioni. Kjo ka bërë që në 10 vjet qeverisjeje i vetmi projekt që mund të quhet “*Made in rilindja*” është Lungomare e Vlorës. Nuk keni asgjë tjetër të nisur dhe të mbaruar në kohën e qeverisjes suaj.

Gjithsesi kthehem te marrëveshja, duke falënderuar zyrtarët e Ministrisë së Mbrojtjes, vota jonë është pro.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Xhaferraj!

Meqë nuk ka më diskutime, si dhe duke marrë paraprakisht votën e opozitës për këtë marrëveshje, besoj se është gjëja më e mirë që bën opozita, pavarësisht deklarimit të rezultateve dhe ëndrrave që ka lënë nëpër sirtarë, që vazhduan të tjerët, mendoj të kojmë në votimin në parim të projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare”.

Kush është dakord në parim?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Falënderoj edhe një herë përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes!

Falënderoj dhe deputetët e opozitës për mbështetjen që dhanë për këtë projektligj kaq të rëndësishëm!

Faleminderit dhe ju të nderuar kolegë deputetë!

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA